



REPUBLIKA E KOSOVËS
REPUBLIKA KOSOVA – REPUBLIC OF KOSOVO

GJYKATA KOMERCIALE

Numri i lëndës: 2024:038659

Datë: 12.02.2024

Numri i dokumentit: 05312950

KE.nr. 2600/22

PROCESVERBAL I SEANCËS PËRGATITORE

I përpiluar më datë 12.02.2024 në GJYKATËN KOMERCIALE, Dhomat e Shkallës së Parë,
Departamenti për Çështje Ekonomike

Gjyqtari:
Florent Zeqiri

Zyrtare Ligjor:
Miranda Murturi

Paditësi : KRMH “UNITETI”, me seli në Mitrovicë

I padituri : OJQ “Ekopartner”, me seli në B.L Runik

Lënda e kontestit: mos përmbushje e kontratës.

Filloi në 09:00
Seanca është publike

Gjyqtari e hap seancën, publikon lëndën e shqyrtimit dhe përbërjen e gjykatës.

Palët pa vërejtje.

Konstatohet se prezent janë:

Për paditësin: A.Th., zyrtar ligjor tek paditësi, sipas autorizimit,

Për të paditurin: askush, gjykata ka prova se i njëjti është ftuar ne mënyre te rregullt, pasi qe ftesën per seance e ka pranuar me datë 29.01.2024, ne seance nuk prezanton, mungesën nuk e ka arsyetuar.

Përfaqesuesi i paditësit deklaron: lidhur me kete çështje ne si pale paditëse nuk kemi interes juridik per vazhdimin e procedurës, meqenëse rezulton se e paditura potencialisht eshte shuar meqenëse nuk ka asnjë informacion ne departamentin e OJQ –së lidhur me statusin e saj, pretendim ky qe është ngritur edhe ne shkallën e dytë, andaj kërkojmë nga gjykata qe padia te konstatohet e tërhequr.

Pas kësaj, gjykata ne kuptim te nenit 261 par.2 të LPK-së merr këtë:

A K T V E N D I M

KONSTATOHET e tërhequr padia e paditësit KRM UNITETI e ushtruar me datë 30.11.2005 kundër te paditurit OJQ Ekopartner me seli në Runik, me objekt kontesti mos përmbushje e kontratës, lënda e identifikuar me shenjen KE.nr. 2600/22.

Ndaj këtij aktvendimi nuk është e lejuar e drejta e ankesës.

Përfundoi në ora 09:20.

Palët prezente e lexuan dhe e nënshkruan procesverbalin pa vërejtje.

I autorizuari i paditësit

E paditura

V e r t e t o j n e:

Zyrtarja Ligjor

Gjyqtari

Numri i lëndës: 2024:038659
Datë: 12.02.2024
Numri i dokumentit: 05312950